

NVA – Ndërgjegjësimi për Votimin e Arritshëm

Raport lidhur me aksesibilitetin e zgjedhjeve
për votuesit e verbër dhe ata me aftësi të
kufizuara në shikim në Evropë



The voice of blind and partially sighted people in Europe

PËRMBLEDHJE

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD) u kërkon të gjitha shteteve që “t’u sigurojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë që t’i gëzojnë ato njëllor si të tjerët”. Këtu përfshihet e drejta për dhënien e votës, e cila është një nga karakteristikat më të njohura të jetës politike në Evropë. Megjithatë, modeli standard i zgjedhjeve që praktikohet në Evropë sot – ku shënohet një kandidat ose një parti e preferuar në një fletë votimi – i përjashton nga kjo e drejtë themelore politike shumicën e 30 milionë shtetasve evropianë me aftësi të kufizuara në shikim.

Ky problem ka provokuar shtimin e literaturës, më së shumti nga organizatat ndërkombëtare. Ndërkohë që këto materiale japin informacione të çmuara për të diskutuar në lidhje me të drejtat politike të personave me aftësi të kufizuara, ato kanë gjithsesi tre të meta. Së pari, mbulojnë vetëm nënseksionet e vendeve në Evropë. Së dyti, me përmirësimet dinamike që janë bërë në kontekstin ligjor, raportet vjetërsohen shpejt. Së treti, shumica e botimeve janë tepër të përgjithshme për përfshirjen e veprimeve konkrete.

Për të adresuar këto mangësi në literaturë, ky raport studion një pjesë të ngushtë të pjesëmarrjes politike – e drejta e dhënies së votës – vetëm nga këndvështrimi i votuesve të verbër dhe i atyre me aftësi të kufizuara në shikim, ose “blind and partially sighted” (BPS) në 45 shtete të Evropës. Ngrihet pyetja se si zgjedhjet mund të projektohen në mënyrë të arritshme, duke bërë të mundur pjesëmarrjen e barabartë të votuesve BPS. Prandaj, raporti veçon kërkesat specifike të personave me aftësi të kufizuara në shikim në lidhje me aksesibilitetin dhe pjesëmarrjen politike, si dhe hollësitë dhe specifikat e projektimit për vendimmarrësit.

Duke u përpjekur për të arritur këtë, raporti është bazuar te shqyrtimi i masave ligjore për zgjedhjet e zakonshme dhe referendumet në 45 shtete, në një Sondazh Ekspert brenda Bashkimit Evropian të të Verbërve (EBU), i cili ka nxjerrë 24 përgjigje, dhe te një studim cilësor për të mbuluar vendet e tjera. Për bërjen e këtij vlerësimi, raporti merr një metodë votimi që të jetë e arritshme nëse garanton që çdo person BPS në fjalë të ketë mundësi të votojë njëllor si gjithë votuesit e tjerë, duke mos qenë i varur nga ndihmat e jashtme dhe duke e bërë këtë në mënyrë të fshehtë.

Ky raport studion shtatë metoda të ndryshme votimi që janë të disponueshme në të paktën një vend evropian. Në të 45 vendet evropiane të anketuara, mënyra standarde e votimit është me fletë votimi. Përveç dyve, të gjitha vendet e lejojnë hedhjen e votës me një asistent. 20 vende lejojnë metoda të ndryshme votimi që më përpara për grupet e ndryshme të votuesve. Në 10 shtete është e mundur të bëhet votimi në mungesë, në formën e votës me postë, ndërsa në 20 shtete është e mundur të bëhet votimi në kuti votimi të lëvizshme. Në 14 shtete është e mundur të bëhet votimi me shabllon. Votimi me autorizim lejohet në pesë shtete. Votimi elektronik praktikohet vetëm në katër shtete. Sondazhi i ekspertëve të EBU tregon qartë se ka një mospërputhje mes metodave të disponueshme të votimit dhe metodave të dëshiruara të votimit për personat BPS. 79% preferojnë votimin elektronik, 71% preferojnë votimin me internet 67% preferojnë votimin me shabllon.

Ekspertët e EBU raportojnë më tej një numër problemesh me metodat ekzistuese të votimit. Lind një pengesë për aksesibilitetin kur ekzistojnë rregulla të ndryshme në ligjet e ndryshme elektorale, pasi kjo e bën më pak të mundshme që zyrtarët të jenë në dijeni për të gjitha masat dhe t'i aplikojnë ato të gjitha. Përveç kësaj, ka probleme që lidhen me fletën e votimit, e cila shpesh është tepër e ndërlikuar dhe tepër e madhe, saqë e bën të pamundur përdorimin e mjeteve ndihmëse. Gjithashtu ka probleme me implementimin praktik të metodave të ndryshme të votimit, për shembull, nëse jo të gjitha pikat e votimit janë të pajisura si duhet me shabllonë për votuesit BPS. Përveç kësaj, ekspertët EBU raportojnë probleme lidhur me ndërgjegjësimin e zyrtarëve të votimit në lidhje me të drejtat ligjore dhe mjetet praktike për votuesit BPS.

Për sa i përket votimit me letër, raporti thekson se në vetvete, kjo formë votimi nuk është e arritshme për shumicën e votuesve BPS. Një votues i verbër nuk është në gjendje të dallojë elementët e ndryshëm në fletën e votimit dhe ta shënojë vetë opsionin ose opsionet e preferuar në të. Megjithatë në parim, votimi në letër mund të projektohet që të jetë i arritshëm për disa votues me kufizime në shikim. Kjo kërkon që madhësia e shkrimit dhe kontrasti në fletën e votimit të jenë të përshtatshme, si edhe syze zmadhuese në kabinën e votimit dhe ndriçim të mirë.

Për sa i përket votimit me asistencë, raporti thekson se kjo është zgjidhja e duhur për t'i bërë zgjedhjet të arritshme për personat me

afësi të kufizuara. Implementimi i votimit me asistencë në Evropë ndryshon gjerësisht në dy parametra. I pari lidhet me mënyrën se si zgjidhet asistenti, ku votuesve duhet t'u jepet liri e plotë për të zgjedhur se kë duan të votojnë. I dyti lidhet me kërkesat për dokumentacion për votimin me asistencë, ku rekomandohet që këto kërkesa të jenë sa më të pakta që është e mundur. Megjithatë, votimi me asistencë kufizon parimin e pavarësisë dhe padashur pengon fshehtësinë e votës.

Për sa i përket votimit me shabllon, raporti tregon ndryshimet në prodhimin dhe shpërndarjen e shabllonëve, në projektimin e shabllonëve dhe të fletëve të votimit, si edhe në prezantimin e përmbajtjes në shabllonë. Shabllonët duhet të prodhohen në një vend të vetëm, duke pasur kohën e mjaftueshme. Në to duhet të ketë shkrim brail dhe shkronja të mëdha me kontrast të mjaftueshëm. Duhet të ketë një model të unifikuar kombëtar të fletëvotimit për të thjeshtuar prodhimin, dhe skedarët audio duhet t'u vihen në dispozicion votuesve BPS para zgjedhjeve. Stampat mund të jenë një mundësi e mirë për sistemet elektorale ku kërkohet që votuesi të shkruajë numra, si edhe për votuesit BPS me vështirësi motorike. Megjithatë, dobia e një shablloni është e kufizuar, pasi ajo e bën të pamundur heqjen e vijës, shtimin ose ndryshimin e radhës së kandidatëve. Votimi me shabllon siguron një shkallë të gjerë pavarësie, dhe në parim garanton fshehtësinë e votës.

Për sa i përket votimit që më përpara, raporti argumenton se ai mund të lehtësojë stresin e votimit në ditën e zgjedhjeve dhe mund t'u japë votuesve BPS të gjithë kohën që u duhet për të marrë një vendim të mirinformuar pa u ndier nën presion. Është mirë të kërkohen sa më pak dokumente shtesë ose të ketë sa më pak kërkesa regjistrimi. Votimi që më përpara është një masë e mirë vetëm nëse është në dispozicion për të gjithë votuesit, dhe aksesibiliteti i tij varet nga fakti nëse ka në dispozicion mjete të tjera, si për shembull shabllonë.

Për sa i përket votimit në mungesë, raporti thekson dy forma shumë të ndryshme të dhënies së votës pa qenë i pranishëm fizikisht në pikën e votimit, përkatësisht votimi me postë dhe votimi në kuti të lëvizshme. Pavarësisht këtij ndryshimi, mundësitë për të votuar jashtë pikës së votimit duhet të jenë në dispozicion për të gjithë votuesit. Duhet të shmangen procedurat e vështira të aplikimit. Shtëpia e një personi BPS ka më të ngjarë të jetë ambienti i përshtatshëm për votuesin, për shembull për sa i përket kushteve të

ndriçimit. Nëse bashkohet me metoda të tjera votimi, atëherë votimi në mungesë ka mundësinë të rritë pavarësinë e votës, por kjo mund të vërë në rrezik fshehtësinë e votës.

Për sa i përket votimit elektronik, metodës alternative më pak të përdorur, implementimi praktik ndryshon nga fakti se sa të përhapura janë makineritë e votimit, proceset e votimit, si edhe nga ndërtimi i makinerisë së votimit dhe i votës elektronike. Rekomandohet që makineritë e votimit të jenë të disponueshme kudo me qëllim që të arrihet numri më i madh i votuesve BPS. Ndërtimi operacional i makinerisë dhe i votimit elektronik duhet të jetë i arritshëm, duke përfshirë konvertues “text-to-speech”, shkrim brail, tinguj konfirmimi akustik dhe butona me prekje. Votimi elektronik ofron gjithashtu avantazhe për vendet me sisteme votimi komplekse, pasi veprimet e tilla si, heqja e vijës, shtimi ose renditja e kandidatëve mund të bëhet më me lehtësi me një ndërfaqe elektronike. Për këtë nuk ka rëndësi nëse makineria mbështetet te një tastierë kompjuteri, një tastierë telefoni apo një makineri me disa butona. Votimi elektronik garanton zgjedhje të barabarta nëse është në dispozicion për të gjithë votuesit. Gjithashtu garanton votim të pavarur dhe të fshehtë, nëse projektohet në mënyrë të arritshme.

Implementimi i të gjitha metodave të votimit varet nga ndërgjegjësimi i zyrtarëve të zgjedhjeve. Ai është i mirë për ndërgjegjësimin nëse zbatohen të njëjtat rregulla për të gjitha zgjedhjet, por është edhe tejet e rëndësishme që zyrtarët e zgjedhjeve të informohen në lidhje me përgjegjësitë e tyre në ditën e zgjedhjeve. Kjo bëhet zakonisht me anë të seancave të trajnimit. Megjithatë, 34 shtete nuk kanë kërkesa trajnimi në ligjet e tyre elektorale. Njëmbëdhjetë shtete kanë kërkesa për trajnim, por ligji i tyre nuk përmend të drejtat politike të personave me aftësi të kufizuara si një komponent trajnimi. Si pasojë, shpesh zyrtarët e zgjedhjeve nuk dinë si të sigurojnë aksesibilitetin e procesit politik për shtetasit BPS. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizatat BPS në vend është një mjet i mirë për të krijuar dhe për të ruajtur ndërgjegjësimin mes zyrtarëve të zgjedhjeve.

Ky raport përmbillet duke përmendur se akti i votimit nuk është i arritshëm plotësisht në asnjë shtet të Evropës. Megjithatë, raporti tregon 26 praktika të mira që mund të krijojnë një eksperiencë votimi më të barabartë, më të pavarur dhe më të fshehtë për votuesit BPS. Ndërkohë që votimi me asistencë duhet të mbetet gjithnjë i mundshëm për votuesit BPS, ai nuk duhet të jetë mundësia e

vetme, siç është në 58% të vendeve të studiuara. Për funksionimin e plotë të metodave për votimin alternativ të arritshëm, nevojitet më tej që zyrtarët e zgjedhjeve të jenë në dijeni të masave ligjore ekzistuese dhe të nevojave të votuesve BPS. Metodave alternative të votimit kanë mundësinë të rritin aksesibilitetin e zgjedhjeve. Për këtë arsye ato mund t'i kontribuojnë mjaft implementimit të Art 29 UNCRPOD në Evropë.

INFORMACION RRETH RAPORTIT AVA

Versioni i plotë i raportit AVA, si edhe versionet në gjuhë të tjera të kësaj përmbledhjeje gjenden në [faqen e internetit të votimit të arritshëm të EBU-së](#).

Raporti AVA është përgatitur në emër të Bashkimit Evropian të të Verbërve nga Benedikt van den Boom (DBSV – Federata Gjermane e të Verbërve dhe Atyre me Shikim të Kufizuar), Gesa Körte (DBSV – Federata Gjermane e të Verbërve dhe Atyre me Shikim të Kufizuar) dhe Daan de Kort (Oogvereniging – Shoqëria e Syrit Holandë). Të gjitha gabimet në këtë raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Për pyetjet lidhur me raportin dhe votimin e arritshëm, ju lutemi kontaktoni:

Antoine FOBE
EBU Head of Campaigning
European Blind Union
E-Mail: ebucampaigning@euroblind.org



Ky raport është financuar nga “Programi i të Drejtave, Barazisë dhe Qytetarisë” i Bashkimit Evropian.

FUNDI I DOKUMENTIT